

20200100203

L I G J
PËR SIGURIM MATERIAL TË PERSONAVE TË PAPUNË PËR SHKAK TË
PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE ME PRONËSI DOMINUESE TË
SHTETIT

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet për marrje dhe mënyrën e shfrytëzimit të së drejtës për sigurim material në formë të kompensimit me para, për personat e papunë të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës në bazë të falimentimit, likuidimit, apo tepricës teknologjike (në tekstin e mëtejme: person i papunë), në ndërmarrjet me pronësi dominuese të shtetit apo pas privatizimit të tyre, në periudhën nga 1 janari 1993, përfundimisht me 30 qershor 2019.

Neni 2

Person i papunë në kuptim të nenit 1 të këtij ligji është personi:

- i cili ka qenë së paku 15 vite në marrëdhënie pune në ndërmarrje me pronësi dominuese të shtetit, të vërtetuar me formularë M1/M2,

- të cilit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në bazë të falimentimit, likuidimit apo tepricës teknologjike, përfundimisht me 30 qershor 2019, në ndërmarrje me pronësi dominuese të shtetit apo të cilit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në bazë të falimentimit, likuidimit apo tepricës teknologjike, pas privatizimit të ndërmarrjes, me kusht që e njëjta të jetë themeluar derisa ndërmarrja ka qenë me pronësi dominuese të shtetit dhe gjatë privatizimit të mos ketë ndodhur ndryshimi i numrit unik amë i subjektit (NUAS), e nëse ka ndodhur ndryshim i numrit unik amë i subjektit (NUAS), ndërmarrja të ketë dalur nga ndërmarrja me pronësi dominuese të shtetit në bazë të ndryshimit të statusit, në pajtim me ligjin,

- i cili në ditën e parashtrimit të kërkesës nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji, është në moshë prej së paku 52 vite (femra), përkatësisht 55 vite (meshkuj),

- i cili e ka realizuar të drejtën për kompensim me para pas 1 janarit 1993 dhe

- i cili nga 30 qershori 2019 deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk ka qenë në marrëdhënie pune.

Neni 3

Ky ligj nuk ka të bëjë për personat të cilët kanë marrë pagesë përcjellëse më të madhe se 12 paga mujore, në lartësi mbi neto pagën mesatare mujore të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e dhënë.

Neni 4

Personi i papunë ka të drejtë për kompensim me para në lartësi prej 34% të neto pagës mesatare të paguar për punëtor në Republikë për vitin paraprak.

Neni 5

Të drejtën për kompensim me para personi i papunë nga neni 2 i këtij ligji, e realizon deri në punësim apo pensionim të tij, përkatësisht deri në krijimin e disa nga bazat për ndërprerje të së drejtës për kompensim me para, të përcaktuara me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

Neni 6

Të drejtë për kompensim me para, në pajtim me këtë ligj, mund të realizojë personi i papunë i cili do të parashtrijë kërkesë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Agjencia e Punësimit) ku është i evidentuar, më së voni deri më 31 janar 2020.

Agjencia e Punësimit, të drejtën për kompensim me para nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton në bazë të kërkesës personale të personit të papunë.

E drejta për kompensim me para, në pajtim me këtë ligj, realizohet nga dita parashtrimit të kërkesës në Agjencinë e Punësimit.

Nëse kërkesa nuk është parashtruar në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, organi kompetent kërkesën do ta hedhë poshtë si kërkesë jo me kohë të duhur.

Neni 7

Me realizimin e të drejtës për kompensim me para në pajtim me dispozitat e këtij ligji, personit të papunë i pushon e drejta për të ardhura në para në baza tjera.

Neni 8

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë dhe Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të sigurojë listë me të dhëna për ndërmarrjet në të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut paraqitet si pronar dominues i kapitalit dhe për ndërmarrjet me pronësi dominuese të shtetit të cilat kanë qenë të privatizuara, e në të cilat nuk ka ndodhur ndryshim i numrit unik amë i subjektit (NUAS), si dhe për ndërmarrjet me numër të ndryshuar unik amë të subjektit (NUAS) të cilat kanë dalur nga ndërmarrjet me pronësi dominuese të shtetit, në bazë të ndryshimit të statusit dhe të njëjtën do ta dërgojë në Agjencinë e Punësimit, në afat prej 30 ditësh nga dita hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 9

Procedurat për realizimin e të drejtës për sigurim material të personave të papunë deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të mbarojnë sipas Ligjit për sigurim material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 132/17 dhe 51/18) dhe Ligjin për sigurim material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 198/18 dhe 241/18).

Neni 10

Për çështje të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj dhe për çështje për të cilat ky ligj nuk udhëzon në zbatim të ndonjë ligji tjetër, zbatohen dispozitat e Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, që kanë të bëjnë me personat e papunë – shfrytëzues të kompensimit me para.

Neni 11

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për sigurim material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit në periudhën nga viti 2000 deri 2004 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 87/2008 dhe 33/14), Ligji për sigurim material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 132/17 dhe 51/18) dhe Ligji për sigurim material të personave të papunë për shkak të

privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 198/18 dhe 241/18).

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.
